V E N D I M
Nr. 157, datë 26.2.1998

PËR FILLIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME NË DISA RRETHE

(Ndryshuar me vendimin nr. 281, datë 9.5.1998; nr. 409, datë 27.7.2000; nr.787, datë 26.11.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrethet Tropojë, Pukë, Peqin, Kurbin, Mallakastër, Gjirokastër, Kolonjë dhe Sarandë, me qendër në këto qytete, hapen dhe fillojnë punën zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.

2. Veprimtaria e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethet Delvinë të mbulohet përkatësisht nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme të rretheve Sarandë.

2.2. Në rrethin e Malësisë së Madhe, me qendër në Koplik, nga data 1 korrik 2000 hapet dhe fillon punën zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

2.3. Kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të marrë masa për lëvizjen, sistemimin dhe sigurimin e dokumentacionit nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Shkodër.

2.4. Për hapjen e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Malësinë e Madhe, këshilli i rrethit të marrë masa për sigurimin e jo më pak se 200 m2 sipërfaqe, për mjediset e kësaj zyre.

2.5. Në strukturën organike të sistemit të regjistrimit, për zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në Malësinë e Madhe, shtohen 5 veta. Shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore, prej 1.3 milionë lekësh, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2.6. Ngarkohen kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme, prfektura dhe këshilli i rrethit të Malësisë së Madhe për zbatimin e këtij vendimi.

3. Për rrethet Fier, Berat, Korçë, Sarandë, Mallakastër, Shkodër dhe Kurbin, këshillat e rretheve, brenda muajit mars të vitit 1998, të sigurojnë mjediset e përshtatshme prej 300m2 në dispozicion të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

4. Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i pasurisë së paluajtshme të marrin masa për transportimin, sistemimin dhe sigurimin e regjistrave të zyrave të hipotekave të këtyre rretheve pranë gjykatës së shkallës së parë, për të mbajtur të paprekura vlerat provuese dhe historike të tyre.

5. Personeli i hipotekave të këtyre rretheve të kalojë brenda strukturës organizative të zyrave të regjistrimit me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe kryeregjistruesit të pasurisë së paluajtshme.

Numri i punonjësve të hipotekave që kalojnë pranë këtyre 8 zyrave të regjistrimit është 9 veta.

6. Ministria e Financave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të përcaktojnë në buxhetin e vitit 1998, mbulimin e shpenzimeve për financimin e veprimtarisë së zyrave të regjistrimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe kryeregjistruesi i pasurisë së paluajtshme.

8. Zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat do të hapen gjatë vitit 1998, u akordohet një fond prej 6600 mijë lekësh për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, 1000 mijë lekë për shpenzime dhe 3000 mijë lekë për investime.

Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Numri i punonjësve për këto zyra është 43.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano